



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR**

**VENDIM**

**Nr. 139, datë 16.04.2020**

**PËR  
CAKTIMIN E GJYQTARËVE PËR GJYKIMIN E ÇËSHTJEVE GJYQËSORE TË  
VEÇANTA NË GJYKATA TË TJERA, TË NDRYSHME NGA AJO KU USHTROJNË  
FUNKSIONET NË MËNYRË TË PËRHERSHME**

Këshilli i Lartë Gjyqësor bazuar në nenet 4/3, 147/1, 147/a, pika 1 germa “a” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenet 2 e 89 të ligjit nr.115/2019 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” në vendimin nr.30, datë 14.02.2019 të Këshillit të Lartë të Gjyqësor që miratoi projektvendimin “Për rregullat dhe procedurat e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme” i ndryshuar, në rastet kur skema e delegimit dhe transferimi i përkohshëm janë të pamjaftueshme për t’iu përgjigjur nevojave aktuale të gjykatave, pasi shqyrtoi relacionet dhe propozimin e Komisionit për Zhvillimin e Karrierës si dhe organizoi shortin, në përfundim të tij,

**VENDOSI:**

I. Të caktojë gjyqtarët për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykatat në nevojë si vijon:

**GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR SARANDË**

1. Gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, Pëllumb Vehbi, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, çështjen gjyqësore me kërkues: Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë; Objekti: “Gjykimin e çështjes penale nr.6, të vitit 2018 në ngarkimi të të pandehurit {...}, i akuzuar për kryerjen e veprave penale: “Vjedhje me armë”, në bashkëpunim dhe e mbetur në tentativë, parashikuar nga neni 140, në lidhje me nenet 25 dhe 22 të Kodit Penal, etj.”.

**GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR PËRMET**

1. Gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, Piro Sota, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet, çështjen gjyqësore me:

**I.** të pandehur: {...}, {...}dhe {...}; të akuzuar për kryerjen e veprave penale të parashikuara nga nenet 77, 278/2, 283/2, 22 e 25 të Kodit Penal:

**II.** kërkues: Fatri Ibro dhe Ilirjan Ibro; objekti: “Zëvendësim mase sigurimi”.

**GJYKATA E APELIT KORÇË**

1. Gjyqtarja e Gjykatës së Apelit Tiranë, Zegjine Sollaku, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Korçë, çështjen penale në ngarkim të të

pandehurve: {...}, {...}, {...}, {...}, etj.; të akuzuar për kryerjen e veprës penale: “Kultivimi i bimëve narkotike, etj.”.

## **GJYKATA E APELIT VLORË**

1. Gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, Irena Brahim (relatore), Enton Dhimitri dhe Izet Salaj, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Vlorë, çështjen penale me kërkuese: Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë; të pandehur: {...}, {...}; Akuza: “Vrasje me dashje”, e kryer në bashkëpunim, mbetur në tentativë, parashikuar nga nenet 76, 25, 22 të Kodit Penal”.

II. Një kopje e vendimit t’i njoftohet kryetarit të gjykatës në nevojë dhe gjyqtarëve përkatës të caktuar për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në një gjykatë tjetër.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me publikimin e tij në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

**PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**